



Data: 01/07/2025

KËRKESË PËR OFERTË

Për blerje kompjuter laptop

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Materialet e kërkuara:	Kompjuter laptop
Afati i dorëzimit të ofertave:	10/07/2025

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 15 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28/06/2022. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar edhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

QDGJSH po zbaton në Bashkinë Vlorë projektin “Ofrimi i shërbimeve të specializuara të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë”, në kuadër të programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe World Vision Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kuadër të projektit, QDGJSH kërkon të kryejë blerjen e 4 kompjuterave laptop.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj kërkesë deri më 10/07/2025, me shkrim në adresën elektronike, dorazi ose në adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore.



Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Qendra për Drejtësi Gjinore do të zhvillojë procedurën e prokurimit për kompjuter laptop sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi i mallit	Sasia	Çmimi/njësi në LEK
1	Laptop HP 250 Core i17-1255U/8GB/512GB SSD Win 11	4	

Specifikime të përgjithshme:

Kompjuterat laptop të jenë në kushte të mira, funksionale, cilësore dhe të dorëzohen në kohën e kërkuar pranë zyrave të Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimin e kërkuar;
- 2) Dorëzimi i ofertës do të bëhet nëpërmjet email-it në adresën e organizatës genderjusticealbania@gmail.com brenda datës 10/07/2025, dorazi ose me postë në adresën postare Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
- 3) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së mallit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit dhe këto dokumente:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër në ALL.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për kryerjen e blerjeve.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri